

REKOMANDIMET NGA KONFERENCA E KATËRT NDËRKOMBËTARE “SIGURIA SI SFIDË KYÇE PËR TRANSPORT TË QËNDRUESHËM DHE MOBILITET”, 20 JANAR 2017, PRISHTINË

1. Implementimi i përpiktë i legjislacionit në fuqi në fushën e trafikut dhe implementimi i Strategjisë Kombëtare për siguri në rrugë, si çelës i vetëdijesimit gradual të qytetarëve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së sigurisë në rrugë.
2. Ngritja e komitetit teknik me përbërje të ekspertëve të fushës sidomos ekspertëve të sigurisë në rrugë, me qëllim të krijimit të kushteve për përmirësim të mobilitetit në transport.
3. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve (kampanjave vetëdijësuese) për siguri në rrugë në mes të institucioneve dhe palëve tjera të interesit, duke respektuar në plotni legjislacionin në fuqi.
4. Trajnimet profesionale një prej metodave më efektive për zvogëlimin e numrit të aksidenteve.
5. Kultura e sigurisë në rrugë duhet të zbatohet përmes zotimit nga menaxhmenti i lartë, dhe duhet të integrohet sistemi i menaxhimit të sigurisë.
6. Identifikimi i shkaktarëve të aksidenteve në trafikun rrugor dhe hulumtimet përkatëse për secilin prej këtyre shkaktarëve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së sigurisë në rrugë.
7. Respektimi i EU direktivës 2003/59/EC me qëllim të zhvillimit të përhershëm profesional të ngasësve profesionist dhe harmonizimi i kualifikimeve të tyre.
8. Ofrimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e aksidenteve rrugore: të drejtat e viktimave të aksidenteve rrugore; kujdesi në rastet e traumave; rehabilitimi; reagimet e duhura ligjore; financimi i organizatave që ofrojnë mbështetje për viktimat.
9. Auditimi i rrugëve nga aspekti i sigurisë rrugore, funksionalitetit, fluksit në përputhje me praktikat dhe standardet më të avancuara evropiane.
10. Aplikimi i formave atraktive për vetëdijësim të qytetarëve për siguri në rrugë, ku qytetarët në vend që të gjobiten në rast të shkeljes së rregullave në trafik, ata të shpërblehen në rast se ngasin mjetet pa gabime dhe respektojnë plotësisht dispozitat ligjore në fuqi.

11. Meqë jemi në fazën e ndryshimeve ligjore dhe harmonizimit të tyre me direktiva të EU-së, vlerësojmë që rolin kyç në informimin dhe sensibilizimin e vazhdueshëm të të gjithë pjesëmarrësve në trafik pa dallim moshe duhet ta ketë dhe ta bëjë Këshilli për Siguri në Trafikun Rrugor me partnerë, përmes broshurave, fletëpalosjeve, billbordeve, ligjërimeve, spoteve televizive, debateve me qytetarë dhe pjesëmarrës, emisioneve të ndryshme televizive, në mënyrë që qytetarët të njoftohet për të gjitha risit, gjë që do të ndikonte në respektimin e tyre dhe rrjedhimisht do të rezultonte me reduktim të aksidenteve fatale, lëndime ose dëme materiale.
12. Ministria e Infrastrukturës dhe Komunitat sa më parë të fillojnë që në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe në konsultim me komunitetin të bëjnë rregullimin teknik të trafikut duke përfshirë të gjitha masat dhe aktivitetet për të ofruar qarkullim të sigurt në trafikun rrugor, në veçanti **“sistemi i rregullimit teknik të qarkullimit rrugor nëpërmes sistemit elektronik dhe të video mbikëqyrjes”**.
13. Sa më parë duhet të bëhet lidhja në mes të transportit ajror – hekurudhor – rrugor (urban dhe ndër-urban). Po ashtu, të gjendet një modul më funksional dhe më i përshtatshëm sa i përket transportit të udhëtarëve me taxi.